

4.4 PARAQITJA E VETIVE TË OBJEKTIT


Paraqitësi mundëson paraqitjen e attributeve të objektit të përzgjedhur, objekteve të lidhura me të dhe objektet e tyre të përfshira. Mund të përzgjidhni një ose disa objekte njëherësh.

Kushti

Objekti duhet të përzgjidhet.

Procedura

1. Hapet paraqitësi. Këtë mund ta bëni në disa mënyra:

- fillimisht përzgjidhni objektin në shfletues dhe më pas metodën **Objekti / Shfaq**
- fillimisht përzgjidhni shkurtoren për objektin në shfletues dhe më pas metodën **Shkurtorja / Shfaq**
- klikoni ikonën  në redaktues, pas fushës me emrin e butonit që prezanton objektin e përfshirë ose atë të lidhur
- përzgjidhni objektin në listën e objekteve të gjetura dhe klikoni butonin **Shfaq**

Hapet dritarja **Paraqitja** me listën e attributeve të objektit të përzgjedhur dhe me listën e objekteve që janë të lidhura me objektin e përzgjedhur ose janë të përfshira në të.



Shënim:

*Në dritaren për kërkim, e cila hapet pas përzgjedhjes së njëres nga klasat, në të cilën janë ruajtur regjistrimet bibliografike ose ato të njësuara, pas klikimit në butonin **Shfaq** hapet paraqitësi, në të cilën objektet e përzgjedhura shfaqen në formatin, në të cilin së fundmi keni paraqitur objektin e këtij lloji të klasës (MARC, nëse keni paraqitur objektin në formatin COMARC/B, Formati standard, nëse keni paraqitur objektin në formatin standard ose Formati bazë, nëse keni paraqitur listën e attributeve të objektit të përzgjedhur).*





2. Për paraqitjen e objektit, i cili është i lidhur me objektin e përzgjedhur ose është i përfshirë në të, fillimisht objektin duhet ta përzgjidhni dhe më pas të klikoni butonin **Hap**. Objekti i përzgjedhur shfaqet në dritaren ekzistuese. Për hapjen e paraqitësit të objektit të përzgjedhur në një dritare të re klikoni butonin **Dritare e re**.

Nëse objektet e përfshira ndodhen në dosjen e objekteve, fillimisht duhet të hapni dosjen duke klikuar dy herë mbi të.



Këshillë:

Paraqitësi për objektin e lidhur ose të përfshirë hapet duke klikuar dy herë mbi të. Objekti i përzgjedhur shfaqet në dritaren ekzistuese.

3. Midis objekteve të lidhura, të cilat i keni hapur në paraqitësin e njëjtë, **prapa** ktheheni përmes ikonës , ndërsa **përpara** shkoni përmes ikonës .
4. Nëse në hapësirën e punës ose në dritaren për kërkim keni përzgjedhur disa objekte dhe keni hapur paraqitësin, në objektin e **mëparshëm** mund të kaloni përmes ikonës  dhe në objektin **tjetër** përmes ikonës .
5. Nëse dëshironi që objektin e paraqitur ta printoni, klikoni butonin **Printo**.



Shënim:

Për printimin e duhur në kompjuterin tuhet duhet të instaloni programin Java, versionin 1.6 ose më të ri.

6. Për mbylljen e dritares së veçantë të paraqitësit klikoni butonin **Mbyll**. Për mbylljen e të gjitha dritareve të hapura të paraqitësve klikoni butonin **Mbyll të gjitha**.